

STATUT
I
"ASIAN CONSULTING AND PROCESSING OFFICE"
SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Sot me datë 01.02.2025 palët në vijim:

Jamely Arabia Chua, shtetase Filipineze, lindur në Naga, dhe banuese me adresë Rruga Pjeter Budi, Pallati 2, Kati 8/03; Tiranë, lindur më 15.10.1975, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim ID nr. 838216502 dhe nr. personal H59015001V;

Dhe

Jan Peter Schneewind, shtetas gjerman, lindur ne Nurnberg, me 16.07.1972, dhe banues me adresë Rruga Pjeter Budi, Pallati 2, Kati 8/03; Tiranë, me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim ID nr. 838738599 dhe nr. Personal H23716004K;

Ka vendosur të krijojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të quajtur "ASIAN CONSULTING AND PROCESSING OFFICE" ("Shoqëria"), në varësi të statutit të shoqërisë në vijim ("Statuti").

KAPITULLI I
EMRI, FORMA, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1. Emri

Shoqëria është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nën shkurtimin "ACPO" sh.p.k. si emer tregtar.

Neni 2. Forma juridike

Shoqëria është person juridik shqiptar dhe ka formën juridike të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar. Forma juridike e shoqërisë mund të ndryshohet në një formë tjetër ligjore të parashikuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me nenin 10.5 të Statutit.

Neni 3. Zyra qendrore

Selia qendrore e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Tiranës (Republika e Shqipërisë), Rruga Reshit Collaku, nr. 1, kati 1, app. 3, Tirane, 1001.

Selia qendrore e Shoqërisë mund të ndryshohet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me nenin 10.2 të Statutit, pa cenuar (i) mundësinë e hapjes së degëve të biznesit brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në rast se zhvillimi i veprimtarive të Shoqërisë konsiderohet i mundshëm, ose (ii) transferimi i shoqërisë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë kur lejohet me ligj.


Neni 4. Kohëzgjatja

Shoqëria do të ekzistojë për një periudhë të pakufizuar.

KAPITULLI II
OBJEKTI DHE VULA

Neni 5. Objekti i Shoqërisë

 JAMELY A - CHUA

 JAN PETER SCHNEEWIND

Objekti i Shoqërisë do të jetë si më poshtë:

- Konsulence për të drejtat e emigracionit dhe ndjekje procedurash për llogari të paleve të treta për leje qëndrimi, unifikim diplomash apo njehesim të çdo lloji certifikate kualifikimi profesional për të huajt.
- Te ushtroje veprimtari të ndërmjetësimit në tregun e punës dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për pale të treta
- Te prodhojë dhe të tregtojë pjesërisht apo module apo usera të platformave të rekrutimit, databazës, vlerësimit të performancës, të permbushjes ligjore dhe të tjera.
- Te lidhë kontrata përfaqësimi në fushën e saj apo dhe të tjera me kompani të huaja apo edhe me individë.
- Trajnime në fusha të ndryshme të gjuhëve të huaja dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore si dhe në fushën e estetikës dhe masazherisë.
- Shitje Online dhe E-Commerce;
- Ofrimi i Shërbimeve të Mbështetjes dhe Logjistikës për Operacione Ndërkombëtare;
- Zhvillimi dhe Inovacioni në Fushën e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

Neni 6

Vula e Shoqërisë

Shoqëria do të ketë vulën e saj e cila do të përdoret nga Administratori. Në rast të humbjes së vulës, Administratori duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Ortakët dhe të ndjekë procedurat ligjore në fuqi për të raportuar humbjen e saj.

Vula e Shoqërisë do të përmbajë; emrin, niptin dhe qytetin ku ajo operon.

Administratori mund t'i japë zyrës së kontabilitetit të drejtën e përdorimit të një vule të ndryshme nga ajo e tij, për të vulosur dokumentet e firmosura prej tyre ose në emër të Administratorit për marrëdhëniet me institucionet e autorizuar, në kontrata ose autorizime të veçanta.

KAPITULLI III

KAPITALI THEMELUES, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

Neni 7. Kapitali themelues i shoqërisë

Kapitali themelues i Shoqërisë është 5 000 000 (lekë), e ndarë në 1 kuotë që përbën 100% të kapitalit themelues të shoqërisë, si më poshtë:

Jan Peter Schneewind, zotërues i një kuote të barabartë me 50% të kapitalit themelues të shoqërisë në vlerë nominale 2 500 000 leke.

Jamely Arabia Chua zotëruese e një kuote të barabartë me 50% të kapitalit themelues të shoqërisë në vlerë nominale 2 500 000 leke.

Kapitali themelues i Shoqërisë mund të rritet ose zvogëlohet në çdo kohë në një ose më shumë herë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me nenin 10.2 të Statutit dhe dispozitat detyruese të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar herë pas here. Në çdo rast, kapitali themelues i shoqërisë nuk mund të ulet nën kufijtë e përcaktuar në ligj.

Rritja e kapitalit themelues të Shoqërisë mund të ndodhë nëpërmjet kontributit në para, në natyrë ose duke përfshirë rezerva dhe fitime të shpërndara në proporcion me kapitalin themelues të zotëruar nga secili ortak.


JAMELY A CHUA


JAN SCHNEEWIND

Neni 8. Të drejtat dhe detyrat e ortakëve

8.1 Ortakët e Shoqërisë janë vetëm ata individë ose persona juridikë që zotërojnë kuota të Shoqërisë ("Ortakët").

8.2 Çdo kuotë e shoqërisë i jep çdo ortaku të drejtën e votës në Asamblenë e Përgjithshme, të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese të Shoqërisë, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, si dhe të gjitha të drejtat e tjera të përcaktuara në këtë Statut, ose në dispozitat ligjore të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

8.3 Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia e kuotave të Shoqërisë i kalohen secilit mbajtës të ri të së njëjtës kuotë të Shoqërisë, duke iu nënshtruar në çdo rast respektimit të dispozitave të nenit 9 të Statutit.

8.4 Ortaku pavarësisht pjesëmarrjes në kuota, nuk mund të konkurojë aktivitetin e kësaj shoqërie.

Neni 9. Transferimi i kuotave të Shoqërisë

9.1 Kushtet e përgjithshme. Ortaku që dëshiron të transferojë ndonjë nga kuotat e tij të Shoqërisë ("Ortaku Transferues") te një person ose subjekt ("Kandidati-Blerës"), duhet të njoftojë ("Njoftimin e Transferimit") të gjithë Ortakët e tjerë me letër rekomande që tregon:

- mbiemrin, emrin, profesionin, adresën ose në rastin e një subjekti emrin e biznesit dhe selinë e regjistruar të Kandidatit-Blerës;
- numrin e kuotave të Shoqërisë që dëshiron të transferojë ("Kuotat e ofruara");
- çmimin ose shumën që Kandidati-Blerësi është i gatshëm të paguajë ose të sigurojë në këmbim të kuotave të ofruara ("Çmimi i Transferimit"); dhe
- kushtet e tjera në të cilat kuotat e ofruara do të transferoheshin.

9.2 Transferimi nëpërmjet dhurimit. Është i mundshëm një transferim te një njësi ekonomike në të cilën (i) Ortaku Transferues zotëron drejtpërdrejt më shumë se 50% të kuotës në qarkullim, dhe (ii) Ortaku Transferues kontrollon pjesëmarrjen, në rast se Ortaku Transferues kuptohet se (i) nuk është më drejtpërdrejt dhe mban indirekt më shumë se 50% të kuotës në qarkullim, ose (ii) Ortaku Transferues nuk e kontrollon më blerësin, ai do t'i transferojë menjëherë kuotat e tij të Shoqërisë përsëri te Ortaku Transferues (i cili do të transferojë mbrapsht, për shmangien e dyshimit. Ky transferim do të konsiderohet si një dhurim);

- një transferim nëpërmjet dhurimit mund të jetë edhe ndërmjet bashkëshortëve dhe/ose bashkëjetuesve të ligjshëm dhe/ose anëtarëve të familjes në shkallën e dytë të Ortakut;
- një transferim nëpërmjet dhurimit është i vlefshëm edhe i miratuar unanimisht nga Asambleja e Përgjithshme.

9.3 Transfertat në rast vdekjeje të një ortaku.

Në rast të vdekjes së një ortaku, kuotat e shoqërisë që zotërohen nga ortaku i ndjerë do t'u kalojnë automatikisht trashëgimtarëve ligjorë të tij. Nëse, me kërkesë të trashëgimtarëve ligjorë të Ortakut të ndjerë, kuotat e Shoqërisë do t'i transferohen një ortaku ose ndonjë personi tjetër të caktuar nga trashëgimtarët ligjorë të Ortakut të ndjerë, çmimi për kuotën e shoqërisë do të nënkuptohet nga vlera e drejtë e ndërmarrjes në treg të Shoqërisë, siç përcaktohet reciprokisht midis trashëgimtarëve ligjorë të këtij Ortaku të ndjerë dhe blerësit përkatës, ose, në mungesë të ndonjë marrëveshjeje për këtë, nga një ekspert i pavarur.

9.4 Periudha e ndalimit

Pa paragjykuar ndonjë dispozitë tjetër të këtij Statuti, duke përfshirë por pa u kufizuar në llojin e transferimit, Ortakët angazhohen të mos transferojnë kuotën në posedim për një periudhë prej pesë (5) vite që nga data e themelimit të Shoqërisë ("Periudha e Ndalimit"), përveç rasteve kur


JAMELY A-CHUA


JAN SCHNEEWIND

vendosin Ortakët që zotërojnë më shumë se 75% të kapitalit të Shoqërisë. Gjatë periudhës së ndalimit, kuotat e Shoqërisë nuk mund të lihen peng, as nuk mund të bëhen objekt i ndonjë garancie tjetër kolaterali qoftë edhe personale, apo tjetër, të drejta ndaj palëve të treta (përveç atyre të parashikuara në këtë Statut), përveç rasteve kur vendosin Ortakët që zotërojnë më shumë se 75% të kapitalit të Shoqërisë.

9.5 E drejta e Refuzimit të Parë

Në varësi të mënyrës së transferimit të kuotave, në rast se një ortak dëshiron të transferojë kuotën e tij në zotërim të Shoqërisë, Ortakët e tjerë kanë të drejtën e refuzimit të parë për të kërkuar kuotën e ofruar për transferim. Çmimi dhe kushtet e tjera të përcaktuara në Njoftimin e Transferimit ("E drejta e Refuzimit të Parë"). Ortakët e tjerë duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre të refuzimit të parë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas Njoftimit të Transferimit (në tekstin e mëtejme "Periudha e Ushtrimit"). Gjatë gjithë Periudhës së Ushtrimit, Njoftimi i Transferimit do të konsiderohet si një ofertë e parevokueshme e Ortakut Transferues ndaj ortakëve të tjerë për të shitur kuotat e ofruara sipas kushteve të përcaktuara në Njoftimin e Transferimit.

9.6 Njoftimi i Ushtrimit. Një ortak që dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij të refuzimit të parë duhet të njoftojë për këtë Ortakun Transferues dhe Ortakët e tjerë ("Njoftimi i Ushtrimit") brenda Periudhës së Ushtrimit. Njoftimi i Ushtrimit do të deklarohet nëse Ortaku përkatës dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij të refuzimit të parë në lidhje me të gjithë ose një pjesë të kuotës së ofruar. Njoftimi i Ushtrimit nuk mund t'i nënshtrohet asnjë kushti (as pezullues, as vendimtar).

9.7 Alokimi.

☐ Kuota e ofruar do t'u shpërndahet Ortakëve që kanë ushtruar të Drejtën e Refuzimit të Parë dhe kjo në përputhje me Njoftimet përkatëse të Ushtrimit, duke sqaruar nëse Ortakët kanë ushtruar të Drejtën e Refuzimit të Parë në lidhje me një pjesë të kuotës e cila në total tejkalon vlerën nominale të përfaqësuar në kapital të zotëruar nga ortaku që ka ushtruar të drejtën e refuzimit, kuotat e ofruara do të ndahen proporcionalisht mes ortakëve në përpjestim me përfaqësimin e tyre në kapitalin e shoqërisë (ku, natyrisht, nuk mund t'i ndahen më shumë pjesë e kuotës së ofruar për transferim një Ortaku sesa numri në respektimin e së cilës ai ka ushtruar të Drejtën e Refuzimit të Parë.

☐ Nëse vlera totale nominale e kuotës së ofruar që Ortakët dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre të refuzimit të parë është i barabartë me një vlerë më të vogël nominale të kuotës së ofruar, e drejta e refuzimit të parë do të konsiderohet se nuk është ushtruar në mënyrë të vlefshme. Në këtë rast, Ortaku Transferues mund të transferojë tërësinë e kuotës së ofruar tek Kandidati-Blerësi, me çmimin e ofertës dhe kushtet e tjera të Njoftimit të Transferimit. Megjithatë, nëse një transferim i tillë nuk kryhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas skadimit të Periudhës së Ushtrimit, atëherë një transferim nuk është më i mundur pa ndjekur më parë procedurën e përcaktuar në këtë nen.

9.8 Pagesa dhe transferta. Ortakët të cilëve u është ndarë kuota e ofruar, do të nënshkruajnë një kontratë transferimi me Ortakun Transferues në kushte në përputhje me dispozitat e Nenit 9.1.2 të Statutit, brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas skadimit të Periudhës së Ushtrimit, dhe ata do t'i paguajë çmimin Ortakut transferues brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike pas nënshkrimit ose, sipas rastit, pas përmbushjes së çdo kushti precedent (të lejuar). Pronësia e pjesës së kapitalit të transferuar nëpërmjet ndarjes së kuotës së ofruar do t'i transferohet Ortakut përkatës me pagesën e çmimit të transferimit dhe pas regjistrimit të dokumentit(ve) përkatës në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KAPITULLI IV


JAMELY A. CHUA


JAN SCHNEEWIND

ORGANI VENDIMMARRËS

Neni 10. Organi vendimmarrës

10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi drejtues i Shoqërisë që vendos për veprimtarinë dhe politikën ekonomike dhe tregtare të vetë Shoqërisë.

10.2 Asambleja e Përgjithshme do të konstituohet në mënyrë të vlefshme me kusht që të paktën një shumicë (dmth., 50%+1) e kapitalit të Shoqërisë është e pranishme ose e përfaqësuar në mbledhje, dhe të gjitha vendimet merren me një shumicë të thjeshtë të votave. Nëse në mbledhjen e parë të ortakëve është e pranishme ose e përfaqësuar më pak se shumica e kapitalit të shoqërisë, një mbledhje e dytë e ortakëve me të njëjtin rend dite do të thirret brenda 7 (shtatë) ditësh pas mbledhjes së parë, e cila mund të vendosë në mënyrë të vlefshme për pikat e caktuara në rend dite, pavarësisht nëse të paktën një shumicë (dmth., 50%+1) e kapitalit të Shoqërisë është e pranishme ose e përfaqësuar.

10.3 Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e thjeshtë të votave (dmth. 50%+1 të kapitalit të shoqërisë), duke iu nënshtruar detyrimeve më të rrepta të shumicës të përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

10.4 Asambleja e Përgjithshme do të thirret nga Administratori ose nga një Ortak që zotëron të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë.

10.5 Asambleja e Përgjithshme do të zhvillohet në zyrën qendrore të Shoqërisë, ose në çdo vend tjetër siç është rënë dakord ndërmjet ortakëve. Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet edhe me videokonferencë ose me telefon nëpërmjet përdorimit të platformave kompjuterike dhe të gjitha mjeteve të tjera të telekomunikacionit elektronik në përgjithësi, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe të jenë në dispozicion për të ndjekur diskutimin dhe për të ndërhyrë në kohë reale për temat e trajtuara.

10.6 Vendi, data dhe ora e zgjedhur për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe çdo thirrje të dytë, si dhe rendi i ditës, do t'u njoftohen Ortakëve me letër rekomande, email ose mjete të tjera të përshtatshme për të verifikuar datën e transmetimit të paktën. shtatë ditë para takimit në adresën fizike ose llogarinë e postës elektronike që rezulton nga Regjistri i Ortakëve.

10.7 Secili ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhje, të paraqesë mendimin e tij dhe të shprehë votën e tij në raport me pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërisë. Secili prej ortakëve ka të drejtë për të paktën një (1) votë dhe secila kuotë e Shoqërisë përfaqëson një votë proporcionale me kapitalin e Shoqërisë. Secili prej ortakëve ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër, duke përfshirë një jo ortak, me anë të të cilit ata mund të shprehin votën e tyre në Asamblenë e Përgjithshme në çdo kohë dhe në rast se një vendim kërkon një shumicë të kualifikuar, me autorizim të vërtetuar nga një noter. Autorizimi mund të nënshkruhet nga një noter publik në vendin ku është i pranishëm Ortaku, edhe nëse ky shtet është jashtë Republikës së Shqipërisë, dhe mund të pranohet vetëm sipas standartit të kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

KAPITULLI V ADMINISTRIMI DHE PËRFAQËSIMI

Neni 11 Administratorët dhe përgjegjësitë

Shoqëria mund të menaxhohet nga një administrator i vetëm (“Administratori”) i identifikuar në personin e:

Jamely Arabia Chua, shtetase Filipineze, lindur në Naga, dhe banuese me adresë Rruga Pjeter Budi, Pallati 2, Kati 8/03; Tiranë, lindur më 15.10.1975, madhore, me zotësi të plotë juridike për



JAMELY A. CHUA



JAMELY A. CHUA

të vepruar, identifikuar me Letërnjoftim ID nr. 838216502 dhe nr. personal H59015001V; për tre (3) vjet.

Neni 12. Përgjegjësitë dhe detyrimet e Administratorit

12.1 Përgjegjësitë e Administratorit në kontekstin e përfaqësimit të Shoqërisë përfshijnë:

- thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, në rastet e parashikuara nga ky Statut dhe nga ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar;
- drejtimin e veprimtarisë së Shoqërisë nëpërmjet zbatimit të politikave dhe planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme; menaxhon burimet njerëzore, duke zgjidhur dhe nënshkruar të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm;
- të sigurojë mbajtjen e saktë të dokumenteve dhe librave kontabël të Shoqërisë;
- përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore, pasqyrave financiare të konsoliduara dhe raportit të progresit së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve të paraqitura në miratimin e Asamblesë së Përgjithshme;
- ngritja e një sistemi alerti për verifikimin dhe monitorimin e çdo situatë, duke iu referuar veçanërisht situatave financiare, të cilat mund të kërcënojnë ecurinë e biznesit dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- kur kërkohet të kryejë regjistrimet dhe regjistrimet e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose subjekte të tjera, drejtpërdrejt ose nëpërmjet personave ose shoqërive të autorizuar;
- përgatit kushtet, certifikatat përkatëse dhe monitoron sigurinë në punë;
- të bashkëpunojë ngushtë me konsulentët e jashtëm për të përmbushur të gjitha detyrimet ligjore të licencimit dhe funksionimit të veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe të ndjekë indikacionet e tyre, si dhe të garantojë sistemin e sigurisë në punë si dhe shërbimet e tjera kur administratori gjykon të drejtat kundër uljen e kostove të administrimit;
- të rekrutojë staf sipas organogramit të miratuar nga kuvendi dhe kushteve përkatëse ekonomike dhe financiare;

12.2 Administratori do të mbikëqyrë dhe garantojë që zyrtarët, agjentët, punonjësit, auditorët dhe konsulentët e Shoqërisë të veprojnë me përgjegjësinë e duhur dhe të mbrojnë më së miri interesat e Shoqërisë. Administratori duhet t'i raportojë Ortakëve mbi aktivitetet e kryera nga të emëruarit dhe të emëruar nga Ortakët në raste të jashtëzakonshme.

12.3 Administratori nuk mund të konkurrojë me Shoqërinë në asnjë rast largimi për të paktën 5 vjet, as gjatë periudhës që ai është në detyrë.

KAPITULLI VII

VITI FISKAL, NDARJA E FITIMEVE DHE LIKUJDIMI

Neni 13. Viti fiskal

Viti fiskal i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti. Viti i parë fiskal i Shoqërisë përfundon më 31 Dhjetor.

Neni 14. Llogaritja dhe shpërndarja e fitimit

Fitimet neto që rrjedhin nga pasqyrat financiare vjetore, pas zbritjes së çdo shpenzimi të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, mund t'u shpërndahen ortakëve në përpjesëtim me pjesëmarrjen në kapitalin e zotëruar. Shuma, mënyra dhe koha e shpërndarjes së fitimeve do të përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Statutin dhe ligjet në fuqi.

 JAMELY A. CHUA

 JAN SCHNEIDER

Neni 15. Shpërndarja e shoqërisë dhe likuidimi

15.1 Shoqëria mund të shpërbëhet në rrethanat e mëposhtme:

- për shkak të skadimit të kohëzgjatjes;
- me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- për të hapur një procedurë falimentimi;
- nëse nuk ka ushtruar veprimtari tregtare për dy (2) vjet dhe nuk i është komunikuar pezullimi i veprimtarisë sipas nenit 43, pika 3, të ligjit nr. 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar; dhe
- me vendim gjykate.

15.2 Administratori (i) regjistron shpërbërjen e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar. Në rast se shpërbërja e Shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9723 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar, shpall vendimin për regjistrim.

15.3 Shoqëria nuk shpërbëhet për shkak të falimentimit të njërit prej ortakëve.

15.4 Në rast të shpërbërjes, Shoqëria duhet të likuidohet.

15.5 Për të menaxhuar procedurën e likuidimit, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidues, të cilët, brenda kohës dhe në mënyrën e përcaktuar me ligj, do të dorëzojnë raportin përfundimtar mbi gjendjen e aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe në kohën e nevojshme për të përfunduar vetë likuidimin.

15.6 Në përfundim të procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme vendos për pasqyrën financiare përfundimtare, për vlefshmërinë e punës së bërë nga likuiduesi dhe për përfundimin e operacionit të likuidimit.

15.7 Pas shlyerjes së detyrimeve, likuiduesi(ët) do të shpërndajnë të ardhurat e mbetura nga procesi i likuidimit tek Ortakët në përpjesëtim me kuotat e Shoqërisë që ata kanë përkatësisht në kapital.

KAPITULLI IX TË NDRYSHME

Neni 16. Të ndryshme

16.1 Pa tejkaluar dispozitat e këtij Statuti, përjashtimi i ortakut, si dhe pasojat që sjell ai, do të trajtohen me dispozitat nr. 101, 102, 103 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

16.2 Ky Statut është hartuar në gjuhën angleze dhe rregullohet dhe përkthehet në përputhje me ligjet shqiptare. Në rast të një konflikti interpretimi, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

16.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë, të cilat nuk kanë mundur të zgjidhen me negociim, do t'i nënshtrohen juridiksionit ekskluziv të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Tiranë (Republika e Shqipërisë).

16.4 Të gjitha aktet e Shoqërisë konsiderohen konfidenciale, dhe përmbajtja e tyre nuk mund të bëhet publike ose t'u zbulohet palëve të treta, përveç për qëllimet dhe nevojat e biznesit të Shoqërisë.

16.5 Marrëdhëniet e punës rregullohen me kontratën e punës dhe me legjislacionin e punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat e punës në fuqi dhe punonjësit janë të detyruar të respektojnë këtë Statut dhe rregullat e brendshme të Shoqërisë. Punonjësit duhet të mbajnë përgjegjësi për çdo dëm që i shkaktojnë Shoqërisë nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.


JANELLY A. GHA


JAN SCHREINER

16.6 Ndalohet konkurrenca e ortakëve me shoqërinë me vendndodhje në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në shoqëri të tjera, qofshin këto jashtë territorit ku shoqëria ka ose do të ketë degë, filial, përfaqësi apo pjesëmarrje në kuota në shoqëri të tjera, drejtpërdrejt dhe tërthorazi, me përjashtim të miratimit paraprak me shkrim të ortakëve të tjerë.

16.7 Çdo çështje tjetër, e cila nuk përmendet në këtë Statut, do të administrohet nga dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.

16.8 Adresat e kontaktit të ortakëve në formë të shkruar janë të përcaktuara në faqen e parë të këtij Statuti.

ORTAKËT E SHOQËRISË


JANYELY A. CHUA


JAN SCHNEEWIND